

VENDIM
Nr. 68, datë 3.2.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË BIBLIOTEKËS “GJERGJ FISHTA” DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË LEZHË SI NJËSI ZBATUESE

(ndryshuar me vendimin nr. 798, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit dhe të rikonstruksionit të Bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, në vlerën 117 000 000 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, për financimin e rforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, të jetë në vlerën 23 400 000 (njëzet e tre milionë e katërqind mijë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 93 600 000 (nëntëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë, pa TVSH, për financimin e rforcimit dhe të rikonstruksionit të bibliotekës “Gjergj Fishta”, Bashkia Lezhë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Lezhë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Çaktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rforcimin dhe rikonstruksionin e Bibliotekës “Gjergj Fishta”.

4. Fondi për financimin rforcimit dhe të rikonstruksionit të Bibliotekës “Gjergj Fishta” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe